



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2737 prot.

Tiranë, më 23.12.2025

VENDIM

Nr. 48, datë 23.12.2025

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi z. _____, (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”), formularin e ankesës nr. 2737 Prot., datë 24.10.2025, saktësuar me shkresën nr. 2737/1 Prot., datë 17.11.2025, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 sh.a., (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, me kërkesën datë 04.10.2025, depozituar nëpërmjet shërbimit postar, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

- 1-12. *Situacionet për vitet 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023, 2024.*
- a) *Pasqyrën Financiare për:*
 - a-a) *Shpenzimet totale*
 - a-b) *Fitimet totale*
 - a-c) *Humbjet totale*
 - a-ç) *Të drejtat e arkëtuara*
 - a-ç-a) *Aktiviteti shfrytëzimit*
 - a-ç-b) *Njësitë ekonomike brenda grupit (biznese në varësinë e shoqërisë e të tjera)*

- a-ç-c) Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (shoqëri të tjera me kontratë qeraje për përdorim nga Rezidenca Studentore Universitare nr.1
- b) Për vitin përkatës të gjitha kontratat e nënshkruara që qerasë me bizneset nën varësinë e shoqërisë apo/dhe me shoqëritë e tjera.
13. Sa është financimi i dhënë nga ana e Ministrisë së arsimit dhe ministritë e tjera të pushtetit qendror që nga nënshkrimi i Paktit të Universitetit deri në vitin 2024, i ndarë në çdo vit përkatës.
14. Sa është organigrama e institucionit dha sa të punësuar janë në total deri në datën 20.7.2025 dhe nga periudha 21.07.2025 deri në 03.10.2025, duke përfshirë rolin dhe pozicionin e tyre të punës, kredencialet dhe kategoritë e ndara në numrin total për çdo rol apo pozicion pune në Rezidencën Studentore Universitare nr. 1?
- a) Deri në datën 20.07.2025, të punësuarit në total me rolin, pozicionin përkatës, kredencialet e tyre dhe kategoritë e ndara në numrin total për çdo rol apo pozicion pune në RSU nr. 1.
Deri në datën 21.07.2025-03.10.2025, të punësuarit në total me rolin, pozicionin përkatës, kredencialet e tyre dhe kategoritë e ndara në numrin total për çdo rol apo pozicion pune në RSU nr. 1.
- b) Të jenë të përfshirë edhe rroga bruto për të punësuarit në këtë pikë që kërkohet.
15. Sa biznese janë privatizuar nga viti 2013 deri në 01.10.2025.
- a) Sa biznese janë nën varësinë e Rezidencës Studentore Universitare nr. 1.

Autoriteti Publik, me shkresat nr. 88/13 Prot., datë 16.10.2025 dhe nr. 88/15 Prot., datë 31.10.2025, i ka kthyer përgjigje ankuesit, duke refuzuar dhënien e informacionit me pretendimin se: "... kredencialet e kërkuara të personave të punësuar në RTU nr. 1 në përputhje me nenin 17 të ligjit Nr. 119/2014, i ndryshuar, me ligjin Nr. 78, datë 21.09.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" përbëjnë informacion konfidencial".

"Gjithashtu, referuar Nenit 9, Parimi i mbrojtjes së të dhënave, të Ligjit Nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, përkatësisht: Organi publik ka detyrimin që gjatë përpunimit të ligjshëm e të drejtë të të dhënave personale, të të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare ose profesionale, me të cilat njihet gjatë procedurës administrative dhe që mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, të ndërmarrë masa lidhur me mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin e tyre. 2. Detyrimi për mbrojtjen, ruajtjen, mos-përhapjen, si dhe konfidencialitetin shtrihet edhe mbi nëpunësin publik, gjatë edhe pas mbarimit të ushtrimit të detyrës, si dhe nenit 15 të tij, Parimi i përgjegjësisë: Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin përkatës".

Të ndodhur në këto kushte, si dhe referuar neneve të sipërcituara, Shoqëria "Rezidenca Studentore nr. 1" sh.a nuk mund të japë informacionin në lidhje me kredencialet e kërkuara.

Në këto kushte, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik

për dhënien e dokumentacionit të kërkuar konkretisht për pikat 14 dhe 15 të kërkesës për informacion, si dhe emrat aktualë të bizneseve dhe personave që i kanë këto biznese.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 2737/2 Prot., datë 20.11.2025, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin, apo procedurën e ndjekur, lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar, duke rivlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion, brenda datës 26.11.2025.

Në vijim, Autoriteti Publik nëpërmjet shkresës nr. 88/17 Prot., datë 26.11.2025, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2737/3 Prot., datë 27.11.2025, ka kthyer përgjigje duke mbajtur të njëjtin qëndrim të mbajtur në kthim përgjigjen e sipërcituar, si dhe duke sqaruar se *Shoqëria Aksionere RSU NR. 1 SH.A, nuk ka statusin e institucionit të mirëfilltë të administratës publike, por është një ndërmarrje që operon konform objektit të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, i ndryshuar, si ligj mbi bazën e të cilit është krijuar kjo shoqëri aksionere dhe mbi bazën e të cilit ajo operon dhe vepron”*.

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi me anë të e-mail-it regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2737/4 Prot., datë 27.11.2025, ka vijuar ankimin, duke thjeshtuar objektin e kërimit, konkretisht informacionin në lidhje me *listën emërore të punonjësve, si dhe emrat e personave që kanë lidhur kontratë qiraje në ambientet e Rezidencës Studentore nr. 1 sh.a.*

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, nuk janë në përputhje me parashikimet e LDI.

Në lidhje me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik, sipas së cilit: “*...Shoqëria Aksionere RSU NR. 1 SH.A, nuk ka statusin e institucionit të mirëfilltë të administratës publike, por është një ndërmarrje që operon konform objektit të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, i ndryshuar, si ligj mbi bazën e të cilit është krijuar kjo shoqëri aksionere dhe mbi bazën e të cilit ajo operon dhe vepron...*”, Komisioneri vlerëson se ky argument nuk qëndron.

Në kuptim të nenit 2, pika 1 të ligjit të sipërcituar “*Autoritet publik*”: a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me

Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike; c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Nga kërkimi i kryer në Qendrën Kombëtare të Biznesit, rezulton se Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1, figuron e regjistruar si Shoqëri Aksionere dhe me kapital të shoqërisë të zotëruar në masën 100% nga Bashkia Tiranë.

Në kuptim të këtij parashikimi, Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1, sh.a., është shoqëri aksionere ku shteti zotëron 100% të aksioneve, si dhe ushtron funksione publike pranë Qytetit të Studentit, rrjedhimisht është Autoritet Publik, dhe subjekt i LDI, i cili detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Në lidhje me refuzimin e dhënies së informacionit mbi bazën e argumentit se: “... kredencialet e kërkuara të personave të punësuar në RTU nr. 1 në përputhje me nenin 17 të ligjit Nr. 119/2014, i ndryshuar me ligjin Nr. 78, datë 21.09.2023 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” përbëjnë informacion konfidencial”. “Gjithashtu, referuar Nenit 9, Parimi i mbrojtjes së të dhënave, të Ligjit Nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, përkatësisht: Organi publik ka detyrimin që gjatë përpunimit të ligjshëm e të drejtë të të dhënave personale, të të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare ose profesionale, me të cilat njihet gjatë procedurës administrative dhe që mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, të ndërmarrë masa lidhur me mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin e tyre. 2. Detyrimi për mbrojtjen, ruajtjen, mos-përhapjen, si dhe konfidencialitetin shtrihet edhe mbi nëpunësin publik, gjatë edhe pas mbarimit të ushtrimit të detyrës, si dhe nenit 15 të tij, Parimi i përgjegjësisë: Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin përkatës”, Komisioneri, gjithashtu vlerëson se arsyetimi i mësipërm nuk është në përputhje me LDI.

Sqarojmë se, LDI rregullon dhënien e aksesit në informacionin publik për çdo person të interesuar. Ky ligj, në nenin 17 të tij gjithashtu përcakton dhe rastet kur dhënia e informacionit jepet në mënyrë të kufizuar. Në këto raste, Autoriteti Publik duhet të tregojë qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që refuzohen, si dhe në bazë të cilës pikë të nenit 17 bëhet ky refuzim. Konstatohet se, Autoriteti Publik edhe pse refuzimin e dhënies së informacionit e ka bazuar në nenin 17 të LDI, ky i fundit nuk ka argumentuar mosvënien e informacionit të bazuar në rastet e parashikuara nga ky nen, apo të ketë bërë një analizë të mirëfilltë, se si kjo e drejtë kufizohet, kur është e domosdoshme, proporcionale, si dhe dëmin që mund t’ë shkaktojë dhënia e emrave të punonjësve, pjesë e organigramës së Autoritetit Publik.

Ndërkohë, duke qenë se informacioni i kërkuar përkon me *emrat dhe pozicionet e punonjësve aktualë të Autoritetit Publik*, ekziston një përjashtim referuar pikës 2 të nenit 44 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në të cilin parashikohet se: *Aksesi i*

publikut në informacionin publik, siç përcaktohet në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, dhe aksesit i publikut në informacionin që lidhet me kryerjen e funksioneve dhe të detyrave zyrtare, nuk pengohet nga e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale të personave fizikë, të cilët konsiderohen si autoritete publike ose ushtrojnë funksione shtetërore, përveç rasteve kur të drejta të tjera themelore, si e drejta e tyre për jetën ose e drejta e tyre për integritet fizik e mendor kërkojnë mbrojtjen e të dhënave të tyre në një rast ose kategori të caktuar rastesh.

Për sa i përket informacionit, në lidhje emrat e personave që kanë lidhur kontratë qiraje në ambientet e Rezidencës Studentore nr. 1 sh.a., në pikën 23, të nenit 5, të ligjit të sipërcituar parashikohet se “Subjekt i të dhënave” është çdo person fizik i identifikuar ose i identifikueshëm. Një person është i identifikueshëm nëse mund të arrihet në identifikimin e tij, duke iu referuar drejtpërdrejt ose tërthorazi një apo disa faktorëve identifikues të veçantë, si: emri, numri i identifikimit, të dhënat për vendndodhjen, një identifikues në internet, ose një apo më shumë faktorëve specifikë, lidhur me identitetin e tij fizik, fiziologjik, identitetin gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror. Po ashtu, bazuar edhe në parashikimet e ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, emrat e subjekteve të regjistruar si persona fizik ose juridik, nuk konsiderohen si të dhëna personale dhe si të tilla nuk gëzojnë mbrojtje nga ligji Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për sa më sipër, referuar legjislacionit të sipërpërmendur si dhe LDI, duke qenë se informacioni i kërkuar lidhet me kontrata publike, informacion ky me efekt në buxhetin e shtetit, rrjedhimisht dhënia e informacionit përbën një interes për publikun.

Në këto rrethana, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se informacioni/dokumentacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 të LDI, sipas të cilit “Informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Gjithashtu, bazuar në nenin 7, pika 1, shkronja d të LDI dhe Urdhrit nr. 187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar” i ndryshuar, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, një pjesë e informacionit të kërkuar përfshihet në kategorinë e informacionit që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Konkretisht, dispozita e sipërcituar përcakton se: “Në përputhje me programin e transparenencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e

pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime”.

Nga sa më sipër, Autoriteti Publik jo vetëm duhet të kishte trajtuar kërkesën për informacion, por në zbatim të nenit 7 të LDI, duhet që informacionin e kërkuar ta bëj publik në mënyrë proaktive në programin institucional të transparencës.

Zyra e Komisionerit thekson se, LDI, ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Në këtë kontekst, sjellim në vëmendjen tuaj se, Zyra e Komisionerit ka krijuar një praktikë të konsoliduar përmes vendimmarrjeve për raste të ngjashme të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare, konkretisht në linkun <https://www.idp.al/vendime-ddi/>, si vendimet nr. 32, datë 10.07.2018, nr. 21, datë 09.04.2021; nr. 23, datë 13.04.2021, nr. 50, datë 17.11.2021, nr.19, datë 15.05.2023, nr. 18, datë 20.06.2025, etj.

Bazuar në pikën 3, të nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.*

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së z. _____, me nr. 2737 Prot., datë 24.10.2025, saktësuar me shkresën nr. 2737/1 Prot., datë 17.11.2025, ndaj Autoritetit Publik, Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 sh.a., me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.*
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit, konkretisht: *“listën emërore të punonjësve, si dhe emrat e personave që kanë lidhur kontratë qiraje në ambientet e Rezidencës Studentore nr. 1 sh.a.”*, brenda datës 06.01.2026.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 23.12.2025

KOMISIONERI

Besnik Dervishi